

## INFORMATATA MBI GRANTIN

Emri i grantit:	Mbrojtja e natyrës nga degradimi mjedisor i shkaktuar nga hidrocentralet në Luginën e Deçanit
Instrumenti:	Grant urgjent
Subjekti zbatues:	OJQ Pishtarët
Kontaktet (adresa, emaili, telefoni, website):	Rruga: "Enver Dobraj", Carrabreg i Epërm, Nr. 36, Deçan, Telefon/fax: + 383 48 599 591 E-mail: pishtaretoj@gmail.com
Kohëzgjatja e grantit:	Data e fillimit: 01.10.2020 Data e mbarimit: 31.12.2020
Buxheti total i grantit (EUR):	5000.00 EUR
Buxheti i mbështetur nga programi EJA Kosovë (EUR):	5000.00 EUR
Grupet e synuara:	Banorët e komunës së Deçanit
Shtrirja gjeografike:	Deçan
Përmbledhje e grantit:	Qëllimi ynë i përgjithshëm është i trefishtë: të avokojmë dhe të rrisim vetëdijen në lidhje me degradimin mjedisor të shkaktuar nga hidrocentralet në Luginën e Deçanit, në pronësi të një kompanie austriake Kelkos Energy sh.p.k. Të parandalojmë që qeveria e Kosovës të lëshojë lejen mjedisore për Kelkos Energy pa e rehabilituar mjedisin dhe në fund, të detyrojmë Kelkos Energy të rehabilitojë të gjithë degradimin mjedisor që kanë shkaktuar në Luginën e Deçanit. Projekti do të implementohet në Komunën e Deçanit. Kryesisht do të prekë banorët e Deçanit dhe fshatrave përreth që varen nga uji që vjen nga Lugina e Deçanit-Lumi Lumbardhi. Ne do të krijojmë hapësira për diskutim publik në mediat sociale; organizojmë një protestë të vogël në Luginën e Deçanit dhe mbledhim, rishikojmë dhe analizojmë dokumentet ligjore dhe shkencore.

Bashkëfinancuar nga: